



BLOGO PËR NJË KAUZË

Udhëzues për Përfaqësim me anë të blogut i Global Voices

NGA MERI XHOJS

Përmbajtja

Ç'është Përfaqësimi me anë të blogut?

- Ç'është përfaqësimi me anë të blogut?
- Pse duhet ta shfrytëzosh blogun për ta përfaqësuar një qëllim?
- Dua të krijoj një blog për përfaqësim por nuk kam aftësi teknike
- Kush duhet të hapë blog për përfaqësim?

Sa llojeve të blogjeve për përfaqësim ekzistojnë?

- Blog për krizë
- Blog për një çështje
- Kur një blog për KRIZË shndërrohet në blog për një ÇËSHTJE

Çka i duhet çdo blogu për përfaqësim?

- Informata elementare
- Risitë aktuale
- Qëllimi i qartë
- Faqe "si të kyçesh"
- E-mail për kontakt

Krijimi i një blogu për përfaqësim

- Zgjedh një qëllim
- Formo ekipin
- Përpilo blogun
- Promovo çështjen tënde

Bëje blogun tënd qendër për aksion

- Ti je udhëheqësi i një komuniteti
- Njihe komunitetin tënd
- Zgjedh një aksion
- Mobilizo komunitetin tënde

Ruaje vetveten

Falënderim

Dëshiroj t'i falënderoj Sami Ben Garbia-n (Sami Ben Gharbia), Etan Cukerman-in (Ethan Zuckerman), Karol Dar-in (Carol Darr), Majkëll Anti-n (Michael Anti), David Sasaki-n (David Sasaki), dhe Xhorxhia Poplevel-in (Georgia Popplewell) për ndihmën që ma dhanë gjatë shkuarjes së këtij udhëzuesi.

Më shumë informata për autorin Meri Khojs mund të gjeni në web-faqen e saj, www.ZapBoom.com

Botuar nga Global Voisis Advokasi (Global Voices Advocacy)

1.


Ç'është përfaqësimi me anë të blogut?

Përfaqësimi me anë të blogut paraqet shfrytëzimin e blogut për të luftuar kundër ndonjë padrejtësie. Njerëzit i shfytëzojnë bloget për të luftuar një sërë padrejtësish, siç është arrestimi me gabim, korrupsioni qeveritar, dëmtimi i mjedisit, dhe keqpërdorimi i të drejtave të njeriut.

Këta 2 udhëzues janë të dobishëm



Udhëzues për njohje me mediat globale të qytetarëve
<<http://rising.globalvoicesonline.org/library/Introduction-to-Citizen-Media-EN.pdf>>



Doracak për Blogues dhe Sajber-Disidentë
<http://www.rsf.org/IMG/pdf/handbook_bloggers_cyberdissidents-GB.pdf>

Pse duhet të shfrytëzohet blog për përfaqësim?

Shumë njerëz hapin blog për përfaqësim për shkak se është mënyrë e lirë dhe e lehtë për të krijuar një web-faqe që trajton një çështje të caktuar. Bloget kanë shabllone të përgatitura më parë që faqes i japin pamje profesionale. Ato shumë lehtë mund të personalizohen me pamjet grafike, ngjyrat dhe fontet tuaja. Gjithashtu, shumica e platformave për blog (p.sh. Blogger dhe WordPress) janë pa pagesë.¹ (Seksioni në vijim përfshin linke për të videot që ju tregojnë se si krijohet një blog me anë të Blogger apo WordPress).

Sidoqoftë, hapja e lehtë dhe pa pagesë është vetëm një nga përfitimet e nisjes së çështjes tuaj në blog. Bloget gjithashtu janë jashtëzakonisht interaktivë. Çdo publikim, ose artikull, ka pjesë ku vizituesit e sajtit mund të japin komente, duke u mundësuar atyre të bëhen pjesë e bashkësisë së faqes dhe në këtë mënyrë të ndjehen më të kyçur në çështjen tuaj. Përveç kësaj, bloget e bëjnë të lehtë punën me më shumë autorë, duke mundësuar që ta ndani punën e azhurimit të blogut. Në fund, në publikimet tuaja mund të bashkangjisni përmbajtje multimediale – si fotografi, video dhe audio. Ky lloj materiali tërheqës është i rëndësishëm për ta bërë blogun tuaj tërheqës dhe joshës për shfrytëzuesit.

Më në fund, blogu është një vegël e shkëlqyeshme për përfaqësim, për shkak se i mundëson çdo individ që ka lidhje Interneti, të fillojë fushatë për ndryshime sociale, mundësisht me përfshirje globale. Qytetarëve të zakonshëm u jep fuqi të habitshme që t'i kundërvihen pushtetit, të veprojnë si burime alternative të informacionit, organizojnë përkrahës dhe të llobojnë te ata që janë në pushtet. Mjetet për ndryshime sociale i keni në majë të gishtave, prandaj filloni të klikoni.

Dua të krijoj një blog për përfaqësim por nuk kam aftësi teknike. Ç'të bëj?

Mënyra më e mirë për të filluar është duke e provuar ndonjë softuer për blogim. Mos harroni se platformat on-line për blogim janë ndërtuar për ta lehtësuar shfrytëzimin nga ana e jo-ekspertëve. Unë arrita ta kuptoj se si ta personalizoj një blog nga Blogger-i (madje [të mësoj edhe pak HTML](#)) duke punuar një pasdite me softuerin dhe duke i kërkuar termat që nuk i kuptoja në Google. Edhe ju mund t'i shihni videot me udhëzime në vijim. Përveç kësaj, *Doracaku për Blogues dhe Sajber-Disidentë* ka disa informata shumë të dobishme për vendosjen dhe promovimin e blogut tuaj.

Edhe Blogger-i edhe Wordpress-i janë platforma të mira për shkak se ofrohen në disa gjuhë, kështu që mund ta krijoni blogun për përfaqësim në gjuhën tuaj, në vend që të punoni në anglisht. Edhe pse përkthimi në anglisht është i rëndësishëm poqese përpiqeni të filloni fushatë ndërkombëtare, blogun tuaj duhet ta filloni në gjuhën tuaj amtare sepse do ta keni më të lehtë mirëmbajtjen e tij.

1 Përderisa Wordpress ofron optimizim optimal sa i përket pamjes dhe strukturës, shërbimet e tjera për blogim që u përmendën, posaçërisht Blogger-i, janë shumë më të lehtë për t'u vendosur. Zgjedheni platformën që i përgjigjet më së shumti nivelit të aftësive teknike të ekipit tuaj.

Këto video demonstruese janë gjithashtu shumë të dobishme



Krijohet blog në Blogger

<<http://tinyurl.com/339xxr>>



Krijohet blog në WordPress

<<http://tinyurl.com/2actbj>>

Kush duhet të hapë blog për përfaqësim?

Fjala “përfaqësim” nënkupton se flisni në emër të dikujt tjetër. Por a keni të drejtë apo leje që të flisni në emër të atij personi apo grupi? Kjo është një pyetje e rëndësishme që duhet t’ia bëni vetes para se të filloni një blog për përfaqësim.

Nëse jeni të lidhur intimisht me çështjen të cilën e përfaqësoni, nëse kjo çështje ju prek personalisht ose padrejtësisht ka ndodhur në qytetin ose vendin ku jetoni, atëherë sipas të gjitha gjasave nuk duhet të shqetësoheni për atë se a keni apo s’keni të drejtë të filloni që blog për përfaqësim. Por, nëse çështja paraqitet në ndonjë shtet tjetër ose e prek dikë që nuk e njihni personalisht, është e pëlqyeshme që të bëni disa kontrollime në një rreth më të gjerë, para se ta filloni blogun tuaj.

Në fillim, duhet t’i kontaktoni njerëzit që janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjen, që të jeni të sigurt se blogu juaj me të vërtetë do t’u ndihmojë atyre. Nëse ju përfaqësoni dikë, duhet patjetër t’i kontaktoni miqtë e afërt të personit në fjalë, ose, në rast ideal, ndonjë anëtar nga familja e tij e ngushtë. Duhet të siguroheni se blogu juaj nuk do të paraqesë përsëritje të ndonjë gjëje që ata tashmë e bëjnë. Gjithashtu, në disa raste, fillimi i një blogu për përfaqësim mund ta *dëmtojë* personin ose çështjen të cilën përpiqeni ta ndihmoni dhe duhet të siguroheni se kjo nuk do të ndodhë.

Një shembull se si *nuk* duhet të fillohet një blog për përfaqësim është blogu “Free Alaa” (Lirojeni Alaanë)², që lloboi për lirinë e bloguesit të burgosur egjiptian Alaa Abd El Fattah në vitin 2006. Unë, së bashku me blogues të tjerë ndërkombëtarë, e filluam blogun “Free Alaa” pa mos u koordinuar mirë me gruan e Alaa-së dhe miqtë e tij në Egjipt. Kjo ishte kontra-produktive për shkak se gruaja e Alaa-së, Manali, përpiquej t’i organizojë të gjitha informatat që kishin të bëjnë me burrin e saj nëpërmjet blogut tyre të ndarë: “Ala and Manal’s Bit Bucket” <www.manalaa.net>. Përveç kësaj, Alaa më vonë na tregoi se ekzistimi i blogut tonë, i cili që atëherë është fshirë, në fakt ka qenë arsye për ta mbajtur atë në burg më gjatë, sepse qeveria e ka konsideruar si njeri me rëndësi që do të thotë edhe rrezik më i madh për ta.

Një shembull më pozitiv është fushata e paradokohshme “Free Fouad” (Lirojeni Fuadin) <<http://en.freefouad.com>>. Edhe pse bloguesi saudian Fouad Alfarhan (Fouad Alfarhan) u arrestua më 11 dhjetor 2007, drejtori i Global Voices Advocacy Sami Ben Garbia (Sami Ben Gharbia) ishte në kontakt me gruan e tij dhe nuk filloi fushatë formale për ta liruar atë derisa ajo nuk dha pëlqim për këtë, thujse dy javë pas arrestimit të tij.

Në fillim, gruaja e Fuadit mendoi se çështja do të zgjidhej në mënyrë të heshtur dhe se publikimi i arrestimit do ta dëmtonte burrin e saj, pasi që pushteti do ta konsideronte si shkaktes i problemeve me dëshirë për t’u organizuar kundër qeverisë. Sidoqoftë, pasi situata e burrit të saj ngeli e pandryshuar, gruaja e Fuadit vendosi se një fushatë publike do t’i ndihmonte burrit të saj për ta fituar lirinë.

Këta dy shembuj e ilustron kompleksitetin e blogimit për përfaqësim. Kjo është arsyeja se pse është aq i rëndësishëm koordinimi me njerëzit që janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në çështjen për të cilën ju angazoheni. Çelësi është *pëlqimi*. Në qoftë se ju përfaqësoni dikë, është obligim i juaj që të përpiqeni ta merrni pëlqimin e tyre ashtu që të mund t’i përfaqësoni ata.

2 Blogu Lirojeni Alaanë (Free Alaa) është përpiluar duke e shfrytëzuar platformën Blogger. Sidoqoftë, para disa muajsh ishte sulmuar nga hakerë dhe përmbajtja e tij ishte fshirë. Ky blog nuk ekziston më.

Cilat janë llojet e ndryshme të blogeve për përfaqësim?

Ka lloje të ndryshme të blogeve për përfaqësim, dhe ky udhëzues është përplot me shembuj të tillë. Mirëpo, mund t'ju ndihmojë nëse bloget për përfaqësim i paramendoni se mund t'u takojnë dy kategorive të ndryshme: bloget për krizë dhe bloget për një çështje. Kategorizimi i blogeve në këtë mënyrë mund t'ju ndihmojë blog-përfaqësuesve që ta formojnë strategjinë e tyre, e poqese ky kategorizim nuk ju ndihmon, lirisht mund ta injoroni atë.

2.

1. Blogu për KRIZË

Blogu për krizë trajton një padrejtësi që mund të zgjidhet shpejt. Ka afat të shkurtër kohor. Bloget për krizë zakonisht kanë

qëllim relativisht të qartë. Shumica e blogeve që kërkojnë lirimin e bloguesve të arrestuar, si p.sh. bloget “Lirojeni Monemin” (“Free Monem”) <www.freemonem.cybversion.org>, “Lirojeni Fuadin” (“Free Fouad”) <<http://en.freefouad.com>> dhe “Lirojeni Karimin” (“Free Kareem”) <www.freekareem.org>, fillojnë si blogje për krizë. “Mos e bllokoni blogun” (Don't Block the Blog), që kërkonte të hiqej bllokimi i përkohshëm i blogeve në Blogger në Pakistan në vitin 2006 <<http://help-pakistan.com/main/dont-block-the-blog>>, është edhe një shembull tjetër i mirë i blogut për krizë.

2. Blogu për një çështje

Blogu për një çështje e trajton një situatë ekzistuese të padrejtësisë e cila nuk ka zgjidhje të shpejtë ose të lehtë. Ka afat të

gjatë kohor dhe shpesh ka disa kërkesa komplekse. Shembuj të blogeve për ndonjë çështje përfshijnë “Grupi i aksionit për të drejta T&T” (Rights Action Group T&T), i cili fokusohet në çështje të mjedisit në Trinidad dhe Tobago <www.rightsactiongroup.blogspot.com>, “Motik” (Motic), që e kundërshton filtrimin e Internetit në Maroko <<http://motic.blogspot.com>> dhe “FAKT Tai” (FACT Thai), që e kundërshton censurën e Internetit në Tajlandë <<http://facthai.wordpress.com>>. Blogje të tjera për ndonjë çështje me rëndësi, përfshijnë Kubatana, që e promovon përdorimin e Internetit nga aktivistët zimbabveanë për të drejtat e njeriut <www.kubatana.net>, dhe “Mos e harroni Burmën” (Don't Forget Burma), një blog me fotografi që i kushtohet fokusimit të vëmendjes në gjendjen politike në atë shtet. <www.dontforgetburma.org>.

<<http://censorship.cybversion.org>>

Lloji: Blog për krizë nga blogu për një çështje

Qëllimi: Ta tërheqë vëmendjen e opinionit publik për censurën agresive që sundon në shtet

Shteti: Tunis

Gjuha: frëngjisht, anglisht, arabisht



SEA-EAT

<<http://tsunamihelp.blogspot.com>>

Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Të ofrojë lajme dhe informata për resurset, ndihmat, donacionet dhe përpjekjet vullnetare pas cunamit të vitit 2000.

Shteti: ndërkombëtar

Gjuha: anglisht



Kubatana

<<http://www.kubatana.net>>

Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Të promovojë shfrytëzimin e Internetit nga organizatat e shoqërisë civile në Zimbabve.
Shteti: Zimbabve
Gjuha: anglisht


3. Kur një blog për KRIZË bëhet blog për një ÇËSHTJE tjetër

Ndonjëherë një blog që fillon si blog për krizë shndërrohet në blog për një çështje, nëse padrejtësia nuk zgjidhet për kohë të shkurtër. Një shembull i mirë për këtë trend është blogu “Lirojeni Karimin” (Free Kareem), i cili filloi si blog për krizë në nëntor të vitit 2006, për të kërkuar lirimin e bloguesit të arrestuar egjiptian Abdel Karim Nabil Suliman (Abdel Kareem Nabil Suliman). Më pas, Karimi u dënua me katër vjet burg për përbuzje të fesë dhe diskreditim të kryetarit. Në atë moment, blogu për krizë me afat të shkurtër kohor u bë me afat të gjatë, pasi që ishte e qartë se, edhe sikur të lirohej Karimi, fushata për ta liruar atë do të jetë e gjatë.

Shembull tjetër i kalimit të blogut për krizë në blog për një çështje është blogu Ndihmë për Cunamin (The Tsunami Help – gjithashtu i njohur edhe si blogu SEA-EAT) <www.tsunamihelp.blogspot.com>, që shërbeu si bazë qendrore për informata dhe ndihma, menjëherë pas cunamit që ndodhi gjatë Kërshëndellave të vitit 2004, e pastaj filloi të merret edhe me katastrofa të tjera natyrore.

Kur një blog për krizë bëhet blog për një çështje, mbajtja e njerëzve të motivuar mund të paraqesë sfidë të vërtetë, pasi që vullnetarët zakonisht lodhen nga fushatat e gjata. Zhvillimi i aksioneve inovative është i rëndësishëm për ta mbajtur të gjallë interesin e vullnetarëve. Gjithashtu është me rëndësi të ruhet funksioni organizativ brenda një afati të gjatë kohor, në mënyrë që të shfrytëzohen ngjarjet kyçe (si p.sh. zgjedhjet) të cilat krijojnë mundësi që çështja juaj të dalë në shesh. Aftësia për t'i shfrytëzuar këto momente të manifestimeve politike është shumë e rëndësishme për të arritur fitore në fushata të çështjeve afatgjata.

Shembuj të blogeve për përfaqësim



Lirojeni Karimin

<<http://www.freekareem.org>>

Lloji: Blog për krizë nga blogu për një çështje

Qëllimi: Të bëjë shtypje për lirimin e bloguesit të arrestuar egjiptian Abdel Karim Nabil Suliman (Abdel Kareem Nabil Suliman)

Shteti: ndërkombëtar

Gjuha: anglisht

<<http://netzpolitik.org>>

Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Të promovojë çështjet që kanë të bëjnë me konceptin për kod të hapur, të drejtat e shfrytëzuesve të Internetit dhe të shprehurit e lirë në sajber-hapësirën.
Shteti: Gjermani
Gjuha: anglisht, gjermanisht



Netzpolitik

<<http://beyondesthestars.ödrpress.com>>

Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Ta promovojë fushatën për mbrojtje të mjedisit në Hong Kong.
Shteti: Kinë
Gjuha: kineze



Beyond the Stars



Grupi aksional për të drejta T&T

<<http://rightsactiongroup.blogspot.com>>

Lloji: Blog për një çështje
Qëllim: Të promovojë qeverisje të mirë dhe zhvillim të pastër dhe të qëndrueshëm.

Shteti: Trinidad dhe Tobago

Gjuha: anglisht

Nëse lexon vetëm një faqe... lexoje këtë! Çka i duhet çdo blogu për përfaqësim?

Informata elementare

1. **Cila** është çështja që ju e përfaqësoni?
2. **Pse** angazhohesh ta përfaqësosh këtë çështje (pse situata konkrete është e padrejtë)?
3. **Kush** është viktimja e kësaj padrejtësie dhe kush e shkaktoi padrejtësinë?
4. Nëse ju protestoni për shkak të ndonjë rasti të padrejtësisë (si p.sh. burgosje), **Kur** dhe **Si** ka ndodhur?

Shembull: Faqja “Për” në blogun “Lirojeni Monemin” (Free Monem)
<<http://freemonem.cybversion.org/about/>>

Njerëzit duhet patjetër ta kenë mundësinë t’i marrin informatat e fundit për çështjen tuaj nga blogu juaj.

Risitë aktuale

Njerëzit duhet patjetër ta kenë mundësinë t’i marrin informatat e fundit për çështjen tuaj nga blogu juaj.

Qëllimi i qartë

Sipas mendimit tuaj, cila do të ishte mënyra, më e mirë për zgjidhur padrejtësinë kundër së cilës luftoni? Qëllimet e qarta dhe të thjeshta janë më të mirat për shkak se lehtë përcillen dhe shërbejnë si motivim efektiv për përkrahësit. Qëllimi juaj është misioni i blogut tuaj për përfaqësim, dhe duhet të jenë në gjendje që atë ta shprehni me një fjali.

Shembull: “SASOD është një grup me seli në Guajanë që angazhohen për çrrënjosjen e diskriminimit në bazë të orientimit seksual.”
<<http://sasod.blogspot.com>>

Faqe “Si të kyçesh”

Njerëzit që e vizitojnë blogun duhet të gjejnë një listë me aksione që mund t’i ndërmarrin për t’u kyçur në çështjen tuaj (shembuj të aksioneve të këtu mund të gjeni në faqen 16)

Shembull:

→ Faqja “Çka mund të bëni ju!” në blogun “Lirojeni Karimin” (Free Kareem)
<www.freekareem.org/what-you-can-do>

→ Faqja “Resurse të aktivistëve” në blogun “Shpëtojeni Darfurin” (Save Darfur)
<http://savedarfur.org/pages/activist_resources>

E-mail për kontakt

Pjesëtarët e shtypit dhe përkrahësit potencialë duhet ta kenë mundësinë të vënë kontakt me ju, shkruesin e blogut. Sigurohuni që ta paraqisni në mënyrë të qartë e-mail-in ku mund t’ju kontaktojnë.

Shembull: ÇështjaJuaj@gmail.com

Krijimi i një blogu për përfaqësim

3.

1. Zgjedheni një qëllim

Është shumë me rëndësi ta zgjedhni qëllimin para se ta filloni blogun tuaj për përfaqësim. A dëshironi që vetëm të ofroni informata për çështjen? A dëshironi të bëni presion për ndryshime politike? A e keni menduar ndryshimin apo jeni të interesuar për reforma të përgjithshme? Qëllimi juaj nuk është i rëndësishëm vetëm gjatë definimit të strategjisë suaj. Ai gjithashtu është i rëndësishëm në motivimin e vullnetarëve tuaj dhe në përcaktimin e suksesit. (Si mund të keni sukses në arritjen e qëllimit tuaj pa mos zgjedhur që në fillim qëllimin që duhet arritur?) Qëllimi i atij, siç është "ngritja e vetëdijes për çështjen X" ose "kundërshtimi i ligjit X" gjithashtu do të jetë shumë e dobishme në fazën tjetër të procesit të krijimit të blogut tuaj për përfaqësim: formimi i ekipit. Të thuash "Dua të bëj një blog që do të jetë qendër e fushatës për lirin e Karimit nga burgu, që do të ofrojë informata për gjendjen e tij dhe do të sygjerojë mënyra se si njerëzit mund t'i ndihmojnë atij" është shumë më joshëse se sa të thuash "Karimi është në burg dhe unë mëdoj se duhet të bëjmë diçka." Njohja e qëllimit që dëshironi ta arrini që në fillim do t'ju sjellë dobi gjatë tërë kohës së ekzistimit të fushatës.

2. Krijoni ekip

Një blog për përfaqësim mund ta krijoni edhe vetë, por që të jetë i suksesshëm do t'ju duhet një rrjet i miqve dhe përkrahësve. Ja një listë me llojet e njerëzve që do të duhet t'ju ndihmojnë të krijoni blog për përfaqësim të klasit të parë. Mendoni për miqtë dhe njerëzit e tjerë që e dini se mund ta realizojnë çdo rol. Gjithashtu mund t'i shfrytëzoni edhe komunitetet on-line, si p.sh. Global Voices, për të gjeturë njerëz që do t'i realizojnë këto role. Mos u mërzi tni nëse nuk gjeni dikë për ta kryer secilën detyrë. Përpiqui të gjeni sa më shumë bashkëpunëtorë të shkathtë që mundeni.

→ **Shkruesit(ët):** Shkrimi i shpeshtë i posteve me lajmet më të reja për çështjen tuaj është detyra juaj më e rëndësishme si blogues për përfaqësim. Në rastin ideal, duhet të shkruani post të ri çdo të dytën ditë (më mirë është çdo ditë). Përpiqui të gjeni bashkautorë që do t'ju ndihmojnë në shkruarjen e përmbajtjes.

→ **Programuesi:** Varësisht se sa të detajuar dëshironi ta bëni blogun, mund të keni nevojë për dikë që është i aftë të përpunojë kod programor. Gjithsesi do t'ju duhet dikush që di HTML, që përdoret për ta ndryshuar stilin e blogut tuaj (fontin, ngjyrën e prapavijës, etj.) e bile mundeni edhe vetë të mësoni se si ta bëni këtë. Gjuhë të tjera kompjuterike, siç janë PHP dhe Javascript, janë të dobishme për krijimin e shtojcave (widgets) si p.sh. simbole të animuara të blogut, por këto kode janë më të vështira për t'u mësuar.

→ **Disenjatori:** Nëse dëshironi që blogu juaj të ketë pamje profesionale, do t'ju duhet dikush që është i mirë në dizajn, ose mund të jetë diçka që mund ta bëni edhe vetë. (Unë e shfrytëzoj programin pa pagesë për grafikë të quajtur GIMP për të bërë banerë dhe bexhe). Për të përpiluar prezantime më të detajuara grafike, si p.sh. video, do të ishte mirë që të gjeni dikë që është i specializuar në krijimin e videove.

Shembuj të blogeve për përfaqësim



"Lirojeni Fuadin" (Free Fouad)

<<http://en.freefouad.com>>

Lloji: Blogu për një çështje
Qëllimi: Ta kundërshtojë arrestimin jologjor të bloguesit Saudian "Fuad Alfarhan" (Fouad Alfarhan).

Shteti: ndërkombëtar

Gjuha: anglisht, arabisht



SASOD Guajana

<<http://sasod.blogspot.com>>

Type: Blog për një çështje
Cause: Ta kundërshtojë diskriminimin në bazë të orientimit seksual në Guajanë.

Shteti: Guajana

Gjuha: anglisht

→ **Mbajtësi i kontakteve:** Kur e promovoni fushatën tuaj, është shumë me rëndësi të keni numër shumë të madh të kontakteve të mira. Do t'ju duhet dikush që njeh blogues të tjerë dhe (në rast ideal) mba kontakte me OJQ-të³ dhe gazetarët.

→ **Përkthyesi:** Ai do t'ju ndihmojë ta përktheni blogun tuaj. Siç u tha në pjesën hyrëse, do t'ju duhet që disa informata kryesore t'i përktheni në anglisht nëse dëshironi të bëni fushatë ndërkombëtare. Ndoshta do t'ju duhet t'i përktheni edhe në gjuhë të tjera, varësisht nga audiencia që e keni si objektiv.

3. Ndërtoni blogun

Ndërtimi i blogut është hapi më i qartë në blogimin për përfaqësim, por zakonisht merr më së paku kohë. Në fakt, njëri nga përfitimet e shfrytëzimit të blogeve për përfaqësim është se a është e mundshme të lëshohet në përdorim një web-faqe tërësisht funksionale për 24 orë apo më pak. Nëse nuk i keni aftësitë e nevojshme që vetë ta ndërtoni blogun, kjo paraqet një mundësi të shkëlqyer për ta shfrytëzuar ekipin që posa e keni formuar.

Në vazhdim keni disa përmbytje që ndoshta do të donit t'i përfshini në blogun tuaj:

→ **Kryesoret:** Siç u theksua në faqen 7, çdo blog për përfaqësim duhet të përmbajë:

- ⊙ **Informata elementare** për çështjen tuaj (çka, ku, kur, kush, pse, dhe si)
- ⊙ **Risitë aktuale** për çështjen
- ⊙ **Qëllimi** se si do të donit që kjo padrejtësi të zgjidhet (p.sh.: Lirojeni Karimin!)
- ⊙ **Faqe "si të kyçesh"** (aktivitetet që mund t'i ndërmarrin njerëzit për ta përkrahur çështjen tuaj)
- ⊙ **E-mail adresë për kontakt** që të mund t'ju kontaktojnë përkrahësit tuaj dhe pjesëtarët e medimeve.

→ **Fotografi:** Në rastin ideal, çdo publikim duhet të ketë fotografi. Në këtë mënyrë blogu juaj do të jetë më tërheqës për vizitorët. Nëse e përfaqësoni ndonjë person, vendosja e fotografive të tija është me rëndësi që të krijoni tërheqje emocionale. Flickr Zeitgeist është një bexh i animuar që ju mundëson t'i paraqitni fotografitë tuaja nga profili që e keni në Flickr, në shiritin anësor të blogut tuaj. <<http://flickr.com/fun/zeitgeist>>.

→ **Video:** Nëse keni ndonjë anëtar të ekipit me aftësi për video produksion, mund të krijoni edhe video që e sqaron çështjen tuaj. Pastaj vendoseni atë në ndonjë faqe për këmbimin e videove siç janë www.YouTube.com dhe www.DailyMotion.com në ç'mënyrë do të fitohet shikueshmëri më e madhe dhe bloguesit e tjerë do të mund ta bashkangjesin atë në blogjet e tyre për ta përkrahur çështjen tuaj. (Këtu ka disa shembuj të mirë të videove për përfaqësim: http://freemonem.cybversion.org/video_multimedia).

3 Organizata joqeveritare

Shembuj të blogeve për përfaqësim



Mos e harroni Burmën

<<http://www.dontforgetburma.org>>
Lloji: Blog për krizë nga blogu për një çështje

Qëllimi: Filloi për ta përkrahur protestën e murgjive, ndërsa tani është një hapësirë ku njerëzit mund të tregojnë se edhe pse Burma nuk është më në qendër të vëmendjes së medimeve, njerëzit akoma mendojnë për Burmën për çdo ditë.

Shteti: ndërkombëtar
Gjuha: anglisht



Motik

<<http://motik.blogspot.com>>

Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Ta dokumentojë censurën e Internetit në Maroko.

Shteti: Maroko
Gjuha: frëngjisht



→ **Bexhet:** Kjo është edhe një detyrë për disenjatorin tuaj. Bexhi është një vizatim i vogël të cilin bloguesit e tjerë mund ta bashkangjesin në blogjet e tyre, për të treguar se e përkrahin fushatën tuaj. Mund të krijoni një bexh për fushatën tuaj që është vetëm një fotografi, ose nëse dizajneri juaj ka aftësi më të mëdha, mund të krijoni edhe bexhe të animuara. (Këtu ka një shembull të mirë të bexhit të animuar nga blogu “Lirojeni Fuadin”: <http://www.alfarhan.org/archives/175>)

→ **Linke për në aktivitete të tjera:** Nëse jeni duke punuar për një çështje të famshme, mund të ketë edhe njerëz dhe grupe të tjera që gjithashtu bëjnë aktivitete dhe krijojnë përmbajtje në përkrahje të çështjes suaj. Është shumë me rëndësi të jeni në kontakt me njerëzit e tjerë që janë të kyçur në çështjen tuaj, në mënyrë që të siguroheni se aktivitetet tuaja janë të koordinuara dhe se e promovoni njëri-tjetrin. Nëse një grup tjetër krijon një aktivitet efektiv, promovojeni në blogun tuaj dhe vendosni një link për ta në shiritin anësor të blogut tuaj, dhe kërkoni që edhe ata ta bëjnë të njëjtën për ju.

→ **Taget:** Taget janë fjalë kyçe që ua shtoni publikimeve tuaja që t’u ndihmoni njerëzve ta gjejnë përmbajtjen tuaj. Faqja <www.technorati.com> është njëra nga kërkuesit më të njohur të blogjeve dhe ka sistem të vetin të tageve. Mund të fusni kod nga web-faqja e Technorati-t në çdo publikim tuajin, dhe atëherë njerëzit mund t’u gjejnë publikimin tuaj në web-faqen e Technorati-t duke i kërkuar ato terme.

4. Promovojeni blogun tuaj

Keni ekip dhe e keni krijuar blogun tuaj. Urime! Tani fillon puna e vërtetë. Duhet ta promovoni çështjen tuaj që të përpiqeni ta përmirësoni padrejtësinë që e luftoni. Si në çdo fushatë tjetër për përfaqësim, duhet ta përcaktoni cakun tuaj: personin ose grupin që ka fuqi ta përmirësojnë padrejtësinë të cilën e lufton blogu juaj. Atëherë duhet t’i bëni presion atij personi ose grupi për ta arritur qëllimin tuaj.

Për shembull, padrejtësia që e luftonte blogu “Lirojeni Monemin” (Free Monem) <<http://freemonem.cybversion.org>> ishte burgosja e paligjshme e bloguesit Abdel Monem Mahmud (Abdel Monem Mahmoud). Qëllimi i tyre ishte që të lirohej Monemi nga burgu dhe caku i tyre ishte qeveria egjiptiane. Në fund, ata kishin sukses, sepse qeveria egjiptiane lëshoi pe ndaj kërkesës së tyre dhe Monemi u lirua më 2 qershor 2007.

Sikurse edhe në rastin “Lirojeni Monemin” (Free Monem), caku i shumë fushatave për përfaqësim është qeveria. Nëse dëshironi që blogu juaj të ketë ndikim të drejtpërdrejtë te qeveria, nuk mjafton që t’i dërgoni një e-mail kryetarit dhe të prisni që ai menjëherë t’ju dëgjojë. Të ndikosh te qeveria është pak më e komplikuar se aq. Por mos u mërzitni. E tëra do të sqarohet.

Vizatimi në faqen tjetër tregon katër mënyra të ndryshme për të ndikuar te qeveria dhe sqaron se në çfarë mënyre funksionon dhe si të përdoren këto metoda. Nëse vizatimi ju duket paksa i ndërlikuar, lexoni sqarimin dhe do t’ju bëhet më i qartë.

Shembuj të blogjeve për përfaqësim



MbretëriaJonë (OurKingdom)
<<http://ourkingdom.opendemocracy.net>>

Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Ta përfaqësojë idenë për kushtetutë demokratike në Mbretërinë e Bashkuar.
Shteti: Mbretëria e Bashkuar
Gjuha: anglisht




Lirojeni Monemin (Free Monem)
<<http://freemonem.cybversion.org>>

Lloji: Blog për krizë
Qëllimi: Të bëjë shtypje për lirinë e bloguesit të burgosur egjiptian Abdel-Monem Mahmud (Abdel-Monem Mahmoud).
Shteti: Ndërkombëtar (Egjipti, Tunisi, Marokja, SHBA-të, Siria)
Gjuha: anglisht, frëngjisht, arabisht

Fotografia 1: Si mund të ndikojë blogu juaj te qeveria

Ky vizatim paraqet pesë mënyra për ndikim te qeveria



1. Kontaktoni **qeverinë**
2. Kontaktoni **qytetarë të tjerë**
3. Kontaktoni **mediumet tradicionale**
4. Kontaktoni **bloguesit e njohur**
5. Kontaktoni një **OJQ**

Do t'i diskutojmë të gjitha këto mënyra dhe do të sqarojmë cilat metoda të presionit ndaj qeverisë janë më të mira. Mund ta shfrytëzoni këtë strategji për të bërë presion mbi caqe të tjera të fuqishme, si p.sh. korporatat ndërkombëtare.

1. Kontaktoni qeverinë

Nëse jeni aktivist politik, qëllimi juaj përfundimtar është të ndikoni mbi qeverinë, kështu që duket sikur mënyra më e mirë do të ishte ta kontaktoni drejtpërdrejt qeverinë dhe të kërkonte që t'ju dëgjojnë.

Për fat të keq, kjo strategji ka pak gjasa të ketë sukses. Edhe sikur të jeni blogues i famshëm, të cilin e njohin të gjithë zyrtarët qeveritarë, kjo nuk ju garanton se ata do t'ju dëgjojnë. Përpjekjet për të bërë presion të drejtpërdrejtë mbi qeverinë kanë pak gjasa të jenë të suksesshme për shkak se qeveria nuk ka arsye që t'ju dëgjojë juve, një blogues i vetëm (prandaj **vija e kuqe** në diagram është e ndërprerë, e jo e plotë).

Nëse jeni vetëm një person, qeveria mund t'ju injorojë shumë lehtë duke mos pasur pasoja negative. Ajo që duhet të bëni është që ta bindni qeverinë se është në interesin e tyre t'ju dëgjojnë. Për ta bërë këtë do t'ju duhen njerëz të tjerë që do t'ju ndihmojnë për të bërë presion mbi qeverinë.

2. Kontakto qytetarë të tjerë

Tani e keni të qartë se ju duhen edhe njerëz të tjerë që t'ju ndihmojnë për të bërë presion mbi qeverinë. Kjo do të thotë se qëllimi juaj është t'i bindni qytetarët e tjerë për vlerën e çështjes suaj, ashtu që ata t'ju ndihmojnë për të bërë presion mbi qeverinë **vija e gjelbër**.

Për fat të keq, siç mund ta shihni nga vizatimi në faqen e mëparme, vija e gjelbër është e ndërprerë në vend që të jetë e plotë, që do të thotë nuk është opsion efektiv për promovimin e çështjes suaj. Arsyeja se pse ky opsion është më pak efektiv është se shumica e njerëzve nuk e dijnë se blogu juaj ekziston. Pra si do t'i informoni të gjithë këta njerëz për blogun dhe fushatën tuaj?

3. Kontaktoni medimet masive

Shumica e njerëzve informatat i marrin nga medimet masive (TV, radio, gazetat dhe revistat). Një strategji për ta bërë publike blogun dhe qëllimin tuaj është që t'u tregohet medimeve masive për to, ashtu që pastaj ata t'i informojnë qytetarët **vija e kaltër e errët**. Nëse pjesëtarët e medimeve konsiderojnë se qëllimi juaj është i rëndësishëm, ata mund të shkruajnë një artikull në gazetë apo revistë ose ta përmendin gjatë emitimit të lajmeve. Njerëzit që dëgjojnë për qëllimin tuaj në medimet massive, pastaj mund të shkojnë të blogu juaj për t'i marrë informatat e fundit për qëllimin tuaj dhe të informohen se si mund të kyçen edhe ata. Duke u kyçur, do t'ju ndihmojnë që të bëni presion mbi qeverinë.

Pra, cilin medium duhet të përpiqeni ta kontaktoni? Gjatë marrjes së vendimit se kë duhet ta kontaktoni, duhet të udhëhiqeni nga këto dy pyetje:⁴



FACT Thai
<http://facthai.ëordpress.com>
Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Ta kundërshtojë censurimin e Internetit në Tajlandë.
Shteti: Tajlandë
Gjuha: anglisht, tailandeze



Free Keyboard
<http://ëëë.freekeyboard.net>
Lloji: Blog për ndonjë çështje
Qëllimi: T'u ndihmojë njerëzve që lirshëm të surfonjë nëpër Internet duke publikuar informata se si t'i iket filtrimit dhe duke publikuar lajme për censurën digjitale
Shteti: Irani
Gjuha: farsi

4 Thanks to journalists and blogger Michael Anti for providing this frameörk.



Kryetari i Bankës Botërore (Ëorld Bank President)

www.worldbankpresident.org

Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Të hidhet dritë mbi “përfshirjen mediale, thashethemet e brendshme, reagimet zyrtare dhe aktiviteti i shoqërisë civile dhe kryetarin e Bankës Botërore,” duke e rritur transparencën.

Shteti: SHBA

Gjuha: anglisht



Save Darfur

<http://savedarfur.org/blog>

Lloji: Blog për një çështje
Qëllimi: Të mbledhë mjete dhe të ngrisë vetëdijen për krizën humanitare në Darfur.

Shteti: SHBA

Gjuha: anglisht

1. Kush dëshironi të ketë njohuri për lajmet tuaja?

A është çështja juaj çështje lokale, diçka për të cilën vetëm njerëzit e vendbanimit apo qytetit tuaj duhet të jenë të vetëdijshëm? Në atë rast duhet të përqëndroheni vetëm te gazetatat, radiot dhe TV-të lokale. Nëse mendoni se çështja juaj meriton vëmendje ndërkombëtare, atëherë mund t’i kontaktoni agjencitë ndërkombëtare të lajmeve si p.sh. The Associated Press, Agence France-Presse, ose Reuters. Shumë gazeta anembanë botës i marrin lajmet e tyre nga këto agjenci.

Sidoqoftë, keni parasysh se dukshmëria dhe lehtësia e qasjes janë në proporcion të kundërt. Mediumet ndërkombëtare do t’i japin dukshmëri më të madhe çështjes suaj, por është më vështirë të vërehesh nga mediumet ndërkombëtare për shkak se ka aq shumë lajme që garojnë për t’u vënë re. Dhe anasjelltas, është më lehtë të keni qasje në ndonjë gazetë apo TV stacion lokal, por niveli i dukshmërisë që ato mund ta ofrojnë për çështjen tuaj është më i vogël për shkak se ato kanë përfshirje lokale.

2. Kush e ka lirinë e majftueshme që të raportojë për qëllimin tuaj?

Faktori i dytë për të cilin duhet të mendoni është se cilët medime e kanë lirinë e majftueshme që të mund të raportojnë për qëllimin tuaj? Shumë shtete kanë medime që kontrollohen ashpër nga qeveria. Në këtë rast, mediumet lokale mund të mos raportojnë për çështjen tuaj, posaçërisht nëse e kritikojnë qeverinë, dhe atëherë duhet të mendoni për t’i kontaktuar mediumet ndërkombëtare.

Sidoqoftë, sikurse edhe në rastin e parë, liria dhe lehtësia e qasjes janë gjithashtu në proporcion të kundërt. Mediumet ndërkombëtare shpesh janë më të lira për të emituar lajm që është kritik ndaj qeverisë shtetërore të shteteve të ndryshme, por është më vështirë të vërehesh nga mediumet ndërkombëtare për shkak se ka aq shumë lajme që garojnë për t’u vënë re nga to. Dhe anasjelltas, është më lehtë të keni qasje në ndonjë gazetë apo TV stacion lokal, por ato mund të mos e kenë lirinë për të raportuar për çështjen tuaj.



Mos e bllokoni blogun

<http://help-pakistan.com/main/dont-block-the-blog/>

Lloji: Blog për krizë nga blogu për një çështje
Qëllimi: Ta kundërshtojë censurën e Internetit në Pakistan
Shteti: Pakistan
Gjuha: anglisht



Pasi ta kenë marrë vendimin sa i përket mediumit lokal apo ndërkombëtar, si do t'i gjeni gazetarët për t'i kontaktuar për lajmin tuaj? Në fillim, bisedoni me anëtarët e ekipit tuaj dhe shihni se a ka dikush kontakt me mediumet (në të vërtetë kjo është puna e mbajtësit të kontakteve). Pastaj shkruani një njoftim për mediat dhe dërgojuni medimeve që i keni përzgjedhur. (Njoftimet për mediat janë gjithashtu jashtëzakonisht të dobishme për kontaktim të OJQ-ve.) Mos harroni se nëse dëshironi t'i kontaktoni mediumet ndërkombëtare, ndoshta do të duhet që njoftimin për mediumet ta shkruani në gjuhën angleze, punë që duhet ta bëjë përkthyesi juaj. Ja si duket forma e një njoftimi për media⁵:

[Titulli]

Për publikim të menjëhershëm

[Emri i juaj, numri i telefonit mobil, E-maili]

[Përmbajtja e njoftimit për media]

Paragrafi i parë i njoftimit për media duhet të përfshijë *kush, çka, kur, kur dhe si* të lajmit tuaj. Nëse gazetari e lexon vetëm paragrafin e parë, ai duhet t'i ketë të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që t'ia propozojë lajmin redaktorit. Dy ose tre paragrafet që pasojnë mund të përfshijnë deklarata (tuaja), detaje, dhe storje specifike, ose sqarim për rëndësinë e çështjes.

Pasi ta dërgoni njoftimin për media, bëhuni gati që t'ju paraqitet gazetari dhe t'ju parashtrijë pyetje. Mos harroni se gazetarët kanë afate kohore, prandaj nëse ju paraqitet ndonjë gazetar, thirrni ata menjëherë dhe jini të gatshëm me një listë të pikave për bisedë në mënyrë që të jepni përgjigje të mira. Kur flisni me gazetarët gjithmonë mbani pranë vetes informata kryesore për çështjen tuaj në mënyrë që pyetjeve të gazetarit t'u përgjigjeni shpejt dhe saktë. Nëse jeni me fat që çështja juaj të përmendet në medime, mos harroni që në blogun tuaj për përfaqësim të vendosni link deri tek ajo informatë. Shfaqja në medime, çështjes suaj i jep kredibilitet, prandaj paraqitni ato në mënyrë të veçantë në web-faqen tuaj.

4. Kontaktoni blogues të njohur

Nëse nuk keni kontakt direkt me mediumet, mund të shfrytëzoni bloge të tjera më të popullarizuara për t'ju ndihmuar që ta risni dukshmërinë tuaj. Në shumicën e vendeve me blogosferë aktive, gazetarët i përcjellin disa bloge kyçe për të fituar ide për tekste të reja. Ajo që duhet të bëni është që t'u shkruani këtyre bloguesve të njohur dhe t'u kërkonit që të shkruajnë për çështjen tuaj **[vija e kaltër e hollë]**. Me pak fat, ndonjë gazetar do ta shohë tekstin në blogun e njohur dhe do të shkruajë për të. (Në disa vende, si p.sh. Kina, gazetarët gjithashtu i kontrollojnë forumet e njohura on-line, prandaj gjeni se cilat janë burimet e njohura on-line të gazetarëve në vendin tuaj.)

5. Kontaktoni një OJQ

Ka edhe një mënyrë tjetër shumë të rëndësishme për ta promovuar çështjen tuaj dhe për ta rritur presionin mbi qeverinë, e ajo është duke kontaktuar një OJQ (Organizatë joqeveritare). OJQ-të i përfqajësojnë interesat e një grupi të qytetarëve. Disa OJQ janë jopolitike, si p.sh. grupet e bashkësisë apo ato religjioze, por shumë OJQ promovojnë çështje të ndryshme. Mbase ekziston një OJQ në botë që do të ishte e interesuar t'ju ndihmojë për ta promovuar çështjen tuaj.

5 Falënderojmë Zefir Tiçaut (Zephyr Teachout) për informatën e ofruar për atë se si shkruhet një njoftim për media.

OJQ-të mund t'ju ndihmojnë në shumë mënyra. Shumë OJQ kanë lidhje të ngushta me mediumet masive, prandaj ato mund t'ju ndihmojnë që të fitoni mbulim mediatik të çështjes suaj. [vija e verdhë e drejtë]. Gjithashtu, disa OJQ kanë lidhje me anëtarët e qeverisë. Kjo do të thotë se ata mund të llobojnë në mënyrë direkte në emrin tuaj [vija e verdhë e lakuar]. Kjo do të ishte një ndihmë e shkëlqyer për çështjen tuaj. Poashtu, OJQ-të kanë përvojë të madhe në përfaqësim, kështu që mund t'ju japin këshilla të shumta të dobishme për të krijuar një fushatë të suksesshme.

Duhet të marrish parasysh kontaktimin e OJQ-ve, si lokale e poashtu edhe ato ndërkombëtare, për të parë se kush mund t'ju ndihmojë. Gjetja e një OJQ-je apo e një personi që mund ta kontaktoni në OJQ është detyrë e mbajtësit të kontakteve. Shpesh OJQ-të lokale kanë kontakte me OJQ-të ndërkombëtare, të cilat zakonisht janë efikase në ushtrimin e presionit ndërkombëtar mbi qeverinë e vendit tuaj.⁶

Një shembull i paradokohshëm i shfrytëzimit të OJQ-së për promovuar një çështje është blogu “Lirojeni Fuadin” (Free Fouad) <<http://en.freefouad.com>>, i cili është krijuar për ta kundërshtuar arrestimin e bloguesit saudian Fuad Alfarhan (Fouad Alfarhan) që ndodhi në dhjetor të vitit 2007, dhe i cili punoi së bashku me OJQ-në e quajtur [Komiteti për mbrojtjen e gazetarëve](#) – KMG (Committee to Protect Journalists - CPJ) për ta promovuar çështjen e tyre.

Njëri nga bloguesit e kyçur në fushatën “Lirojeni Fuadin” (Free Fouad), [Sami Ben Garbia](#), kishte një mik në KMG dhe e kontaktoi atë për t'i treguar atij për arrestimin e Fuadit. Atëherë KMG e shfrytëzoi aftësinë e saj për të lobuar qeveritë e huaja duke i dërguar letër Mbretit Abdullah të Arabisë Saudike duke kërkuar lirinë e Fuadit. KMG-ja gjithashtu i shfrytëzoi lidhjet e saja me mediumet dhe OJQ-të tjera për ta promovuar rastin e Fuadit.

Javën, në të cilën KMG-ja e dërgoi letrën e saj, shumë gazeta dhe rrjete televizive anembanë globit filluan të raportojnë për rastin e Fuadit, duke përfshirë New York Times, BBC dhe CNN. Në kohën kur shkruhej ky udhëzues, gjenerali Mensur el-Turki, zëdhënësi i Minsitrisë për Punë të Brendshme, tha se Fuadi do të lirohej së shpejti.

Bashkëpunimi me OJQ-të mund të rrisë ndikimin e fushatës suaj në mënyrë dramatike.

6 Më shumë për fushatat ndërkombëtare për përfaqësim, shih librin “Aktivistë përtej kufijve” (Cornell University Press, 1998) nga Margaret Keck (Margaret Keck) dhe Ketrin Sikink (Kathryn Sikkink).

4.

Bëjeni blogun tuaj qendër për aksion

Po japim disa këshilla se si ta bëni blogun tuaj jo vetëm qendër të informative por edhe qendër për aksion.⁷

Ju jeni udhëheqës i një komuniteti

Kini parasysh se ju jeni udhëheqësi i një komuniteti dhe se njerëzit që vijnë te blogu juaj janë të interesuar për çështjen dhe dëshirojnë të ndihmojnë⁷. Bëjeni misionin të qartë për ta që t'i motivoni, tregojuni se si ata përputhen me atë mision, dhe tregojuni se çka mund të bëjnë ata për të ndihmuar.

→ Jini të vetëdijshëm se njerëzit e komunitetit tuaj sipas të gjitha gjasave do të jenë “*ndikues*.”⁸ Ndikuesit janë njerëz që janë aktivë në fushën qytetare dhe politike, kanë shumë miq dhe njerëz që i njohin, janë të aftë që të ndikojnë te këta miq dhe t'i bindin që të kyçen në fushatën tuaj, dhe dëshirojnë t'i lexojnë lajmet e fundit. Nëse ndikuesit i bëni të jenë të kënaqur dhe i shfrytëzoni ata në mënyrë efikase, fushata juaj do të lulëzojë.

Njiheni komunitetin tuaj

→ Kur ta keni komunitetin, duhet ta nxirrni maksimumin nga anëtarët e këtij komuniteti. Pyetni ata se çfarë përgatitje profesionale kanë dhe pastaj kërkojeni ndihmën e tyre.

→ Kërkoni që t'ju japin ide se si ta përmirësoni fushatën tuaj dhe pastaj dëgjoni seriozisht sygjerimet e tyre. Seksionet për komente të postimeve janë mundësi e shkëlqyer për këtë.

→ Herën tjetër që keni ndërmend të ndërmerni ndonjë veprim apo paraqitje të re, do të ishte mirë që t'i anketoni anëtarët e komunitetit që të shihni se ç'mendojnë ata për këtë. Mbani mend, nëse propozoni ndonjë aksion dhe askush nuk merr pjesë në të, ai nuk mund të ketë sukses. (Mund të krijoni një anketë pa pagesë në www.freepolls.com ose www.pollhost.com dhe t'ia bashkangjisni blogut tuaj.)

→ Mbani evidencë se sa vizita në ditë keni në blogun tuaj dhe nga cilat vende vijnë vizitorët tuaj. ClustrMaps <www.clustrmaps.com> ju mundëson që këto informata t'i paraqitni në mënyrë vizuale.

Zgjedhni një aksion

→ Tani keni një komunitet. Është koha që atyre t'u përcaktoni ndonjë aksion ku mund të marrin pjesë. Qëllimi i aksionit është të bëjë presion mbi “cakun” tuaj – personi që ka fuqi ta përmirësojë padrejtësinë që ju e luftoni. Nëse padrejtësia është politike, caku juaj sipas të gjitha gjasave është ndonjë politikan. Nëse çështja juaj ka të bëjë me ndonjë veprim të gabueshëm të ndonjë ndërmarrjeje, caku juaj mund të jetë drejtuesi i ndërmarrjes.

→ Shpesh është e paqartë se kush saktësisht e ka fuqinë ta përmirësojë padrejtësinë. Shumë kierarki të fuqisë nuk e zbulojnë se kush është përgjegjës për një aksion në mënyrë që t'i ikin mundësisë për t'u marrë në përgjegjësi. Kur keni dyshime, vendosni qëllim të lartë. Nëse jeni aktivist politik, për cak merreni Kryetarin ose ndonjë deputet të Kuvendit, i cilë e përfaqëson zonën ku ka ndodhur padrejtësia. Nëse padrejtësia është bërë nga ndonjë ndërmarrje, për cak merreni drejtorin e përgjithshëm.

→ Faqja juaj “Si të kyçesh” duhet të përmbajë disa aksione që mund t'i ndërmarrin njerëzit për ta përkrahur çështjen tuaj. Në rast ideal, aksionet duhet pëmbajnë nivele të ndryshme të angazhimit kohor që të jenë tërheqëse për grupe të ndryshme përkrahësish.

7 Kjo pjesë është shkruar në bashkëpunim me Karol Dar (Carol Darr), ish-drejtoresh e Institutit për politikë, demokraci dhe Internet në Universitetin e Washingtonit

8 “Poli-ndikuesit: Mbretërit e krijimit të politikës së re,” gjendet në www.ipdi.org/Publications/default.aspx

Në vazhdim është dhënë një listë e aksioneve të mundshme që mund të ndërmerren për ta përkrahur çështjen tuaj. Mund të krijoni gjithashtu edhe aksionet tuaja. Krijimi i aksioneve të reja dhe origjinale paraqet mënyrë për t'i mbajtur njerëzit të përkushtuar për çështjen tuaj dhe për t'a tërhequr vëmendjen e medimeve ndaj çështjes për të cilën ju bëni presion. **Nënshkruani e-Peticion:** Një e-peticion online është një nga llojet më të shpejta dhe më të lehta të aksioneve për shkak se një përkrahës mund ta nënshkruajë një petition për disa minuta.

- ⊙ Mund të krijoni një petition pa pagesë në www.thepetitionsite.com/create-online-petition ose www.ipetitions.com, dhe pastaj vendosni një link për te petitioni në blogun tuaj për përfaqësim.
 - ⊙ Organizata ndërkombëtare për aktivizëm digjital Avaaz <www.avaaz.org> shpesh i shfrytëzon petitionet gjatë fushatave të tyre të përfaqësimit. Mund ta vizitoni ëeb-faqen e tyre për të parë disa shembuj të shprehjeve që ata i përdorin.
 - ⊙ Pasi të konsideroni se janë mbledhur një numër i mjaftueshëm nënshkrimesh në petitionin tuaj, shtypeni dhe jepjani personit që e keni përcaktuar si cak të petitionit tuaj.
 - ⊙ Nëse mendoni se është e sigurt, mundeni të krijoni edhe një video tuajën duke ia dorëzuar petitionin personit zyrtar që e keni përcaktuar si cak (ose duke u përpjekur për të bërë një gjë të tillë) dhe pastaj ta publikoni atë video në blogun tuaj për përfaqësim.
- **Shkruani përfaqësuesit tuaj politik:** Nënshkrimi i një petitioni është një mënyrë që njerëzit të tregojnë se e përkrahin çështjen tuaj. Sidoqoftë, shpesh ndikimi është më i madh nëse kërkoni që njerëzit t'i shkruajnë letër personit zyrtar që e keni përcaktuar si cak, në vend që vetëm të nënshkruhen në një petition.
- ⊙ Ky aksion kërkon më shumë kohë, prandaj ka më shumë gjasa të korrni sukses nëse kërkoni nga vullnetarët kryesorë (shihë pjesën në vazhdim) që ta ndërmarrin këtë aksion.
 - ⊙ Për një fushatë me shkrim të letrave, duhet që të vendosni informata në ëeb-faqen tuaj që do t'u ndihmojë njerzëve ta identifikojnë se kush është përfaqësuesi i tyre lokal. Gjithashtu mund të ofroni informata për kontakt se ku duhet të dërgohet letra (në rast ideal, përkrahësi duhet ta ketë mundësinë që letrën ta dërgojë me e-mail, për shkak se kjo është më e lehtë se sa t'u kërkohet atyre që atë ta dërgojnë me postë).
 - ⊙ Për ta shkruar letrën, është me rëndësi që njerëzve t'u ofrohet një letër në formë të formularit të cilën ata pastaj mund ta ndryshojnë ose një listë me pika që mund ta vendosin në letrën e tyre, në mënyrë që procesi i shkrimit të letrës të jetë sa më i shpejtë dhe sa më i lehtë.
 - ⊙ Në përgjithësi, letrat origjinale të bazuara në pika të renditura janë më efikase se sa letrat në formë formulari, në ç'rast të gjitha letrat e përkrahësve janë të njëjta. Kjo është për shkak se shkruarja e një letrë origjinale merr shumë më tepër kohë, prandaj edhe është mënyrë më efikase për ta treguar përkushtimin ndaj çështjes suaj. Sidoqoftë, ka më shumë gjasa që përkrahësit të dërgojnë letër në formë formulary për shkak se merr më pak kohë. Përkrahësve duhet t'u jepet mundësia që të dërgojnë letër në formë formulary, por me pika të renditura që ata të mund ta ndryshojnë dhe ta bëjnë më personale.
 - ⊙ Mund të bëni edhe fushata "Thirrni në telefon përfaqësuesin tuaj politik", nëse i keni numrat e telefonit të përfaqësuesve tuaj politik. Nëse vullnetarët tuaj dinë si ta përdorin programin Skype, mund të bëni aksion edhe në nivel ndërkombëtar.
- **Bojkotoni prodhimin X:** Nëse caku juaj është ndonjë ndërmartje, mendoni për ta bojkotuar ndonjërin nga prodhimet e tyre. Bojkotin mund ta shpallni në blogun tuaj për përfaqësim.
- ⊙ Një mënyrë për ta promovuar bojkotin është duke krijuar bexhe për blog ku qëndron "Unë e bojkotoj X-in" të cilin pastaj bloguesit e tjerë që marrin pjesë në bojkot, mund ta vendosin në bloget e tyre për ta treguar pjesëmarrjen e tyre në bojkot dhe ta promovojnë bojkotin te lexuesit e tyre.
- **Nënshkruaj një zotim:** Për t'i inkurajuar njerëzit që ta respektojnë përkushtimin që e kanë shprehur për fushatën tuaj, shpesh është ide e mirë që të nënshkruajnë një zotim apo kontratë ku thuhet se ata e kanë bërë këtë përkushtim.
- ⊙ Web-faqja www.PledgeBank.org ka shumë zotime që mund t'i shihni për të parë disa shembuj.
 - ⊙ Nënshkrimi i zotimit ka për qëllim dy gjëra:

- E para, ka më shumë gjasa që njerëzit ta respektojnë përkushtimin e tyre, për shkak se kanë bërë edhe deklaratë formale për përkushtimin.
- E dyta, mund t'i mblidhni emrat e të gjithë njerëzve që e japin zotimin (nënkuptohet me leje të tyre) dhe të përpiloni një listë për t'ia dorzëuar caktuar të aksionit tuaj, ngjashëm siç do ta kishit bërë me peticionin.

→ **Organizoni një aksion off-line (jashta Internetit):** Bloget për përfaqësim paraqesin mënyrë të mirë për të organizuar aksione off-line, si p.sh. tubime proteste ose manifestime ku njerëzit nga publiku mund të vijnë dhe të mësojnë për çështjen tuaj.).

- Muund ta promovoni aksionin tuaj off-line duke e publikuar në blogun tuaj dhe duke u dërguar letra njerëzve nga lista juaj e kontakteve.
- Shumica e aksioneve off-line janë lokale. Për shembull, studentët në Çile në vitin 2006 shfrytëzuan foto-bloge për të ngritur vetëdijen për protestat masive ku kërkonin kualitet më të mirë të arsimit.
- Gjithashtu mund të promovoni edhe aksione ndërkombëtare off-line, siç ka bërë fushata “Lirojeni Karimin” (Free Kareem), duke organizuar tubime para ambasadave të Egjiptit anembanë botës për rritjen e vetëdijes për arrestimin e bloguesit egjiptian Abdel Karim Nabil Suliman (Abdel Kareem Nabil Suliman).

→ **Përforcimi i fjalimit të heshtur:** Aksionet për “Përforcim” përfshijnë shpërndarjen e fjalimit që është heshtur, qoftë me largimin e përmbajtjes nga Interneti ose me arrestimin e ndonjë aktivisti.




- Ka disa aksione që janë posaçërisht të përshtatshme për grupe të posaçme të vullnetarëve ose për qëllime të posaçme. Për shembull, përforcimi është më i mirë kur cak janë bloguesit, ndërsa shfrytëzohet më mirë për të përkrahur raste të censurimit dhe të arrestimit.
- Një organizatë e njohur që e përdori përforcimin si teknikë të aktivizmit digjital ishte Amnesty International, fushata “E pandalshme” (Irrepressible) <<http://irrepressible.info>> e së cilës u kërkoi bloguesve që të publikojnë bexhe në bloget e tyre të cilat rrotullonin citate nga përmbajtje on-line që janë censuruar.
- Pastaj, fushata “Lirojeni Monemin” (Free Monem) krijoi një bexh që rrotullonte citate të bloguesit të arrestuar Abdel Monem Mahmud (Abdel Monem Mahmoud). Fushata “Lirojeni Fuadin” (Free Fouad) ka bexh të ngjashëm <www.alfarhan.org/archives/175>.
- Mesazhi i përforcimit është i qartë: burgosja e një aktivisti nuk e hesht fjalën e aktivistit, përkundrazi e përforcon atë.

→ **Përpiloni një shenjë të dukshme:** I kam përmendur shenjat e dukshme në kontekst të aksioneve të tjera, por do të doja t'i diskutoja pak më detajisht. Shenja e dukshme është shenjë që e tregon besnikërinë tuaj ndaj një çështjeje.

- Bexhet e blogeve për përfaqësim, si ato që u përmendën në dy shembujt e mëparshëm, janë shembuj të shenjave të dukshme on-line.
- Gjithashtu mund ta shfrytëzoni blogun për të organizuar shenja të dukshme off-line, si p.sh. t'u kërkoni njerëzve të që të veshen me të kuqe në një ditë të caktuar. Kjo është ajo që e bënë përkrahësit e tubimeve për demokraci në Burmë në vitin 2007. Ata shfrytëzuan web-faqe on-line, një grup Facebook, dhe blogje, për të kërkuar që njerëzit të vishen kuq më 21 shtator 2007. Pastaj ata kërkuan që njerëzit të fotografohen të veshur me të kuqe dhe ato fotografi t'i vendosin në grupin Burma në Facebook <<http://harvard.facebook.com/group.php?gid=24957770200>>.

- Vendosja në Internet e paraqitjeve off-line është kyçe. Një demonstratë off-line do të mund të shihet vetëm nga një numër i caktuar njerëzish në një vend të caktuar, por nëse atë paraqitje e fotografoni apo e inçizoni si video dhe e publikoni në blogun tuaj për përfaqësim, atëherë shumë më tepër njerëz do të mund ta shohin atë dhe të kuptojnë për çështjen tuaj.



Mobilizoni komunitetin tuaj: Le të jetë e LEHTË

- ➔ Anëtarët e komunitetit janë vullnetarët që mundësojnë që aksionet tuaja të kenë sukses.
- ➔ Siç këni mundur ta vëreni nga shembujt e pjesës së mësipërme, qëllimi juaj në krijimin e aksioneve për komunitetin tuaj të vullnetarëve është që të “jenë të lehta.”
- ➔ Kini parasysh se vullnetarët kanë kohë të kufizuar dhe respektojeni atë kohë duke i bërë aksionet sa më të lehta dhe sa më të qarta që të jetë e mundur. Sa më i lehtë të jetë një aksion, aq më shumë njerëz do të marrin pjesë në të, e poashtu edhe sukcesi i fushatës do të jetë më i madh.
- ➔ Paramendojeni komunitetin tuaj të vullnetarëve si një piramidë. Shumica e njerëzve janë vullnetarë normalë <e kuqe> dhe janë të gatshëm të japin shumë pak kohë për çështjen tuaj. Një numër shumë më i vogël i njerëzve janë vullnetarë kryesorë <e portokalltë> dhe janë të gatshëm të ndajnë një pjesë të rëndësishme të kohës. Vetëm një grusht njerëzish <e gjelbër> do të bëjnë punë vullnetare për role udhëheqëse dhe në të vërtetë t’ju ndihmojnë ta udhëhiqni fushatën. Duhet të keni strategji, për të punuar me të gjitha këto grupe.
- ➔ Çelësi është të keni aksione në faqen tuaj “Si të kyçesh” për të gjitha nivelet e përkushtimit. Pastaj përkrahësi mund ta zgjedhë atë që i pëgjigjet më shumë.

Figura 2 Komuniteti i vullnetarëve të blogut tuaj për përfaqësim



- **Vullnetarët normalë** Shumica e anëtarëve të komunitetit janë njerëz me angazhime. Aksionet që ua propozoni atyre bëni që të jenë sa më të shkurtëra. Kjo është njëra nga arsyet se pse kohët e fundit peticionet elektronike (e-peticionet) janë aq të popullarizuara. Duhet vetëm 2 minuta për ta nënshkruar. Telefonimi ose dërgimi i e-mailit apo mesazhit SMS një politikani mund të bëhet në për kohë të shkurtër nëse i ofroni informatat përkatëse për kontakt. Për bloguesit, kërkesa nga bloguesit e tjerë që të publikojnë një bexh për promovimin e çështjes suaj në blogun e tyre është një aksion i shpejtë dhe i lehtë. Kjo paraqet ekuivalentin digjital të vendosjes së një ngjitëseje në veturë!
- **Vullnetarët kryesorë** Nga një numër i vogël i vullnetarëve “kryesorë” të cilët janë me të vërtetë të përkushtuar, mund të kërkonti që të ndërmarrin edhe aksione më të komplikuar, por rregull “bëni ato të lehta” akoma vlen. Nëse ata organizojnë një tubim, jepuni listë të gjërave që duhet t’i bëjnë ashtu që planifikimi i manifestimit të jetë më i lehtë. Dhe gjithmonë jini të gatshëm të ofroni udhëzime dhe përkrahje personale. Mbani mend, puna e tyre ndihmon në suksesin e fushatës suaj.
- **Ekipi udhëheqës** Ekipi udhëheqës ka për detyrë t’ju ndihmojë në përgatitjen e strategjisë dhe detyrave të përditshme të cilat janë të nevojshme që fushata juja të jetë efikase. Nësi i dëgjoni ata dhe konsultoheni me ta do të përfitoni nga ekspertiza e tyre. Në qoftë se vetëm i urdhëroni për punë të ndryshme ata nuk do t’ju dëgjojnë më dhe fushata juaj do të ketë vështirësi.

5.

Ruaje veten

Përfaqësimi shpesh herë përfshin ndërmarrjen e pozicioneve jo të popullarizuara ose kontroverse në kritikën e njerëzve me fuqi, veçanërisht anëtarëve të qeverisë. Nëse mendoni se materiali në blogun tuaj për përfaqësim mund të sjellë telashe, atëherë konsideroni mundësinë për blogim anonim.

Blogimi anonim paraqet pengesë që ato që i thoni në blogun tuaj, të ketë ndikim në punën tuaj, privatësinë tuaj dhe sigurinë tuaj. Ka disa mënyra se si e ruani anonimitetin gjatë blogimit.

1. Mos përdorni asnjë informatë personale në blog, si p.sh. emrin tuaj, punëdhënësin, shkollën ose qytetin ku jetoni.
2. Përdorni pseudonim ose mos përdorni fare emër.
3. Asnjëherë mos publikoni fotografitë tuaja në blog.
4. Mos përdorni blogim apo shërbim të e-mailit me pagesë. Informatat tuaja të pagesës mund të shfrytëzohen për ta zbuluar identitetin tuaj.
5. Hapeni një e-mail llogari duke përdorur informata të rrejshme (mos e përdorni emrin tuaj të vërtetë, apo adresën tuaj të vërtetë, etj.)
6. Shfrytëzoni kompjuterë të ndryshëm për të publikuar në blogun tuaj, ashtu që blogu i juaj të mos lidhet vetëm me një IP adresë (seri unike e numrave e përcaktuar për çdo kompjuter të lidhur në Internet). Identifikimi i kompjuterit nga i cili janë vendosur publikimet, është vetëm një hap larg nga identifikimi i juaj.
7. Shfrytëzoni “proksi server” për të shfletuar nëpër Internet (kjo e fsheh IP adresën tuaj).
8. Për të arritur siguri maksimale, kërkoni nga ndonjë mik i juaj që jeton në ndonjë vend me liri më të mëdha që ta udhëheqë blogun tuaj për përfaqësim, duke ua dërguar atyre informatat e nevojshme dhe duke shfrytëzuar e-mail llogari anonime. (shih numrin 5).
9. Global Voices Advocacy ju rekomandon që ta shfrytëzoni proksi serverin Tog dhe platformën për blogim Wordpress.

Kjo është vetëm një njoftim i shkurtër për sigurinë online, ndërsa për informata dhe udhëzime më të detajuara për atë se si t'i shfrytëzoni teknologjitë e përmendura më lartë, konsultoni udhëzuesit në vijim:

- Titulli: “Blogimi anonym me Wordpress dhe Tor”
Botuar nga: Global Voices Advocacy (2007)
Shkarkimi: <http://advocacy.globalvoicesonline.org/tools/guide/>
- Titulli: “Udhëzues për blogues dhe sajber-disidentë”
Botuar nga: Raportuesit pa kufij - Reporters Without Borders (2005)
Shkarkimi: http://www.rsf.org/IMG/pdf/handbook_bloggers_cyberdissidents-GB.pdf



Fund

← Tani dilni dhe ndryshojeni botën! →